

VENDIM
Nr. 725, datë 2.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.488, DATË 22.7.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË PARCELËS
NDËRTIMORE PËR OBJEKTET PA LEJE, ME FUNKSION BANIMI DHE TË
PËRZIER, TË SUBJEKTEVE QË PËRFITOJNË ULJE TË PAGESËS, SI DHE TË
MËNYRËS E AFATEVE TË PAGESËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe/ose tetraplegjik, në kuptim të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, e që kanë statusin e të verbrit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me paraqitjen e dëshmisë zyrtare përkatëse pranë drejtorisë së ALUIZNI-t, detyrimi financiar për vlerën e parcelës ndërtimore falet.

Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, që kanë në përbërje familjare persona me statusin e invalidit paraplegjik dhe/ose tetraplegjik apo me statusin e të verbrit, detyrimi financiar për parcelën ndërtimore zbritet në masën 50% nga vlera e llogaritur, në bazë të kreut I, të këtij vendimi.”.

b) Në pikën 10, të kreut III, fjalët “... brenda një viti ...” zëvendësohen me “... brenda gjashtë muajve ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama